



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:293467

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05427199

Ac.nr.5655/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka - kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Enes Mehmeti anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. B. nga fshati R. i M., Komuna e L., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit P. B. avokate në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Fatime Mustafa, me objekt të kontestit kompensimi i pagave të trembëdhjeta, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.688/19, të datës 14.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më **08.03.2024** nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET SI E THEMELTË, ankesa e paditësit Sh. B. nga fshati R. i M., Komuna e L., ashtu që: **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.Nr.688/19 i datës 14.04.2022 dhe gjykohet si në vijim:

II.APROVOHET e themeltë kërkesëpadia e paditësit Sh. B. nga fshati R. i M., Komuna e L.t. **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit-Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që paditësit t'ia paguaj shumën e tri pagave në vlerë të pagës bazë prej 425.00 euro, në emër të pagave të trembëdhjeta (13-ta) për vitet 2018,2019 dhe 2020, shumën e përgjithshme prej 1,275.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

III.DETYROHET e paditura Komuna e Lipjanit-Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej **104 euro**, për një seancë të shtyer shumën prej **67,50 euro**, për një seancë të mbajtur shumën prej **135.00 euro**, për taksë për padi shumën prej **20.00 euro**, shuma e përgjithshme

326.50 euro, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit me detyrim.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.688/19 të datës 14.04.2022 ka vendosur si në vijim:

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit Sh. B. nga fshati R. i Madh Komuna e L., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit, në emër të tri pagave të 13-ta për vitin 2018, 2019 dhe 2020 në shumë të përgjithshme prej 1.275 euro me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 443.50-euro, **si e pa bazuar**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi Sh. B. , përmes përfaqësues së tij të autorizuar, P. B. për shkak të shkeljes esencila të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e aprovuar në tërësi si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika e), në lidhje me nenin 201, pika d), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit Sh.B. nga fshati R. i M./Komuna e L., është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi Sh. Bo., përmes përfaqësueses së tij të autorizuar P. B. F., avokate nga Lipjani, me datë 19.12.2019 ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ndërsa përmes parashtresës së datës 19.05.2021 ka bërë zgjerimin e padisë me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditësit t'ia paguajë shumën e dy pagave të fundit në emër të shpërblimit jubilar, si dhe në emër të pagave të trembëdhjeta nga viti 2018 deri në vitin 2020 t'ia kompensoj shumën e tri pagave bazë. Në seancën kryesore të mbajtur me datë 14.04.2022, dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditësit ka theksuar se qëndron në tërësi pranë parashtresës për rregullimin e kërkesëpadisë në kuptimin objektiv dhe precizimin e kërkesëpadisë në pikëpamje të lartësisë të datës 28.01.2022, ndërsa e tërheq kërkesëpadinë vetëm sa i përket shpërblimit jubilar, nga se paditësi këtë të drejtë e ka realizuar në procedurë administrative. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar dhe atë për padi shumën prej 104 euro,

për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 104 euro për një seancë gjyqësore të shtyer të datës 16.03.2022 shumë prej 67.50 euro, një seancë të mbajtur shumë prej 135.00 euro, për taksë për padi dhe aktgjykim në shumë aq sa do ti llogarisë gjykata, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

E paditura, në përgjigje në padi e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Më tutje ka shtuar se Ministria e Shëndetësisë me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka bërë harmozimin e saj me Ministrinë e Financave, që Komunës me qarkore buxhetore të ju lejohet ngritja e tavanit të pagave, në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor në kuadër të kodit ekonomik paga dhe mëditje dhe me këtë rast e paditura nuk ka mundësi financiare ti paguaj pagat jubilarë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur seancë kryesore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.688/19 të datës 14.04.2022, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pa themeltë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se paditësi sipas kontratës së punës Nr.-3-192/2012-SH, të datës 16.01.2012, është në marrëdhënie pune teke paditura në cilësinë e teknikut të laboratorit, ndërsa nga vërtetimi me numër 223/2019 të lëshuar nga e paditura vërtetohet fakti se paditësi ka filluar marrëdhënien e punës nga data 01.10.1999 ku ende vazhdon të punoj dhe sipas listës së pagave vërtetohet se paga bazë për paditësin është në shumë prej 425 euro. Sipas dispozitës së nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale është përcaktuar se *“Punëmarrësi mund të paguhet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*. Andaj, në bazë të gjendjes së tillë të çështjes, rezulton se kërkesa e paditësit duhet refuzuar tërësisht, me arsyetimin se dispozita e nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale nuk e detyron punëdhënësin (këtu të paditurën) për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, për shkak se e njëjta thotë se punëmarrësi mund të paguhet me pagën e 13-të për çdo vit kalendarik, në vlerë të pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, e meqë në rastin konkret e paditura e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin e pamundësisë së mjeteve buxhetore për pagesën e pagës së trembëdhjetë për paditësin, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës gjykata e mori sipas dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimin i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por gjykata e shkallës së parë

gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale për sa i përket aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit për shpërblimin jubilar, gjë që u desh që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Në këtë drejtim, nuk mund të pranohet pretendimi për këtë shkelje sepse ndryshimi i aktgjykimit ka të bëjë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e jo me arsyetimin e gabuar. Zbatimi i gabuar i të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë e ka përcaktuar edhe arsyetimin e aktgjykimit për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2018, 2019 dhe 2020 në atë mënyrë që përfundimi meritor është arsyetuar në përputhje me dispozitat e LPK-së, pavarësisht se një përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë, gjykata ankimore e ka ndryshuar.

Përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2018, 2019 dhe 2020, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar.

Me dispozitat e nenit 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me parag.3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tre (3) vjet”*.

Me dispozitën ligjore të nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 parashihet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*

Nga interpretimi i kësaj dispozitave ligjore, si dhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme me numër , 212/2023, i datës 09.10.2023, lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për kompensimin e kushteve ligjore për shpërblimin e pagës së 13-të, Gjykata e Apelit, nuk e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale. Sipas Gjykatës së Apelit, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se

dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizmin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Andaj, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë.

Në rastin konkret, e paditura nuk ka ofruar asnjë provë për ta mbështetur pretendimin e saj se nuk ka mjete buxhetore për t'ia kompensuar pagës së 13-të paditësit, në kuptimin e nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së dhe nenin 322 paragrafi 3 të LPK-së ku parashihet se *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, andaj, Gjykata e Apelit e aprovon ankesën a paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të themeltë.

Vendimin për shpenzimet e procedurës kjo gjykatë e ka bazuar në dispozitën e nenit 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 465 paragrafi 2 të LPK-së, duke ia njohur paditësit pagesën e shpenzimeve të procedurës sipas pikës **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit në bazë të nenit 194, 195 par.1 pika e), lidhur me nenin 201, pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5655/2022, datë 08.03.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Besnik Feka